

Data 31/05/2024

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR
KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Mbeshtetje Per Programin 2024 - 2026 - Shërbime Projektimi, i ndarë në Katër Lote:

- Loti 1: “Hartimin e masterplaneve, dhe/ose përgatitje ToRs, dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit, dhe/ose përgatitje të dokumenteve për tenderim, për objekte të konektivitetit, rrugë dhe ura, furnizim me energji elektrike, rrjete telefonike dhe teknologji informacioni, rikualifikimit të shesheve urbane, mobilimit urban, parkime mbi tokë dhe nën tokë, infrastrukturave urbane, shëtitore dhe fasada, peisazhe, mbrojtje nga erozioni detar, erozioni lumor, trajtime ujrash dhe/ose çdo projekt tjetër me natyrë të ngjashme në ndërhyrje infrastrukturore mbi tokë dhe nën tokë.”
- Loti 2: “Hartimin e masterplaneve, dhe/ose përgatitje ToRs, dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit, dhe/ose përgatitje të dokumenteve për tenderim, për objekte civile, industriale, sportive, residenciale, publike dhe/ose kulturore, mbi tokë dhe nën tokë.”
- Loti 3: “Hartimin e masterplaneve, dhe/ose përgatitje ToRs, dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose projekteve të zbatimit, dhe/ose përgatitje të dokumenteve për tenderim, për objekte të trashëgimisë kulturore, restaurime të monumenteve të kulturës apo objekte të tjera të trashëgimisë kulturore, realizimin e muzeve (bashkohore apo trashigimi kulturore), galeri arti, arredim/interiere dhe/ose muzealizim.”
- Loti 4: “Hartimin e masterplaneve, dhe/ose projekteve teknologjike, dhe/ose projekteve të detajuara, dhe/ose përgatitje të termave të referencës, dhe/ose përgatitje të dokumenteve për tenderim, për objekte industriale, teknologji, informacion, objekte ekologjike miqësore me mjedisin, bio-teknologjike, me efikasitet energjie, industriale, mekanike, impiante, sinjalistike, kontrolle aksesi, sisteme të automatizuara, impianti trajtimi ujrash, përpunim bimesh medicinale, përpunim qumështi, blegtori, bujqësi etj.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 73300000-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 333,333,333 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar te kembimit te Bankes se Shqipërise kjo vlere konvertohet ne 3,281,808.92 Euro.

- Loti 1: “Hartimin e masterplaneve, dhe/ose përgatitje ToRs, dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit, dhe/ose përgatitje të dokumenteve për tenderim, për objekte të konektivitetit, rrugë dhe ura, furnizim me energji elektrike, rrjete telefonike dhe teknologji informacioni, rikualifikimit të shesheve urbane, mobilimit urban, parkime mbi tokë dhe nën tokë, infrastrukturave urbane, shëtitore dhe fasada, peisazhe, mbrojtje nga erozioni detar, erozioni lumor, trajtime ujrash dhe/ose çdo projekt tjetër me natyrë të ngjashme në ndërhyrje infrastrukturore mbi tokë dhe nën tokë”, me fond limit të marrëveshjes kuadër 166,666,667 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërise kjo vlerë konvertohet në 1,640,904.46 Euro.

-Loti 2: “Hartimin e masterplaneve, dhe/ose përgatitje ToRs, dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit, dhe/ose përgatitje të dokumenteve për tenderim, për objekte civile, industriale, sportive, residenciale, publike dhe/ose kulturore, mbi tokë dhe nën tokë”, me fond limit të marrëveshjes kuadër 83,333,333 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërise kjo vlerë konvertohet në 820,452.22 Euro.

-Loti 3: “Hartimin e masterplaneve, dhe/ose përgatitje ToRs, dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose projekteve të zbatimit, dhe/ose përgatitje të dokumenteve për tenderim, për objekte të trashëgimisë kulturore, restaurime të monumenteve të kulturës apo objekte të tjera të trashëgimisë kulturore, realizimin e muzeve (bashkohore apo trashigimi kulturore), galeri arti, arredim/interiere dhe/ose muzealizim”, me fond limit të marrëveshjes kuadër 41,666,667 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërise kjo vlerë konvertohet në 410,226.11 Euro.

-Loti 4: “Hartimin e masterplaneve, dhe/ose projekteve teknologjike, dhe/ose projekteve te detajuara, dhe/ose përgatitje të termave të referencës, dhe/ose përgatitje të dokumenteve për tenderim, për objekte industriale, teknologji, informacion, objekte ekologjike miqësore me mjedisin, bio-teknologjike, me eficencë energjie, industriale, mekanike, impiante, sinjalistike, kontrolle aksesi, sisteme të automatizuara, impianti trajtimi ujrash, përpunim bimesh medicinale, përpunim qumështi, blegtori, bujqësi etj”, me fond limit të marrëveshjes kuadër 41,666,666 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërise kjo vlerë konvertohet në 410,226.11 Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor FSHZH ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

- Loti 1: “Hartimin e masterplaneve, dhe/ose përgatitje ToRs, dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit, dhe/ose përgatitje të dokumenteve për tenderim, për objekte të konektivitetit, rrugë dhe ura, furnizim me energji elektrike, rrjete telefonike dhe teknologji informacioni, rikualifikimit të shesheve urbane, mobilimit urban, parkime mbi tokë dhe nën tokë, infrastrukturave urbane, shëtitore dhe fasada, peisazhe, mbrojtje nga erozioni detar, erozioni lumor, trajtime ujrash dhe/ose çdo projekt tjetër me natyrë të ngjashme në ndërhyrje infrastrukturore mbi tokë dhe nën tokë”, me fond limit të marrëveshjes kuadër 166,666,667 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 1,640,904.46 Euro.

12. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kritereve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e Lotit (vlera e fondit limit).

Për operatorët e huaj, në rastet kur në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të vërtetuar bilancet/pasqyrat financiare apo xhiron vjetore, mund të paraqesin një deklaratë për konfirmin e tyre .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.* Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, ate 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, I ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të

periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre- viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Argumentimi për kriterin në pikën 2.3.1: Ky kriter vërteton eksperiencën në fushën objekt prokurimi me qëllim realizimin sipas fazave të projektit dhe sipas afatit. Përvoja e operatorit është një element shumë i nevojshëm për autoritetin, për të vërtetuar qendrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Neni 46 i Ligjit 9643/2006, neni 28/3 të VKM-së 914/2014, janë bazat ligjore për vendosjen dhe miratimin e këtij kriteri. Në kuptim të nenit 46/1/b të LPP-së, operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurorhet dhe jodiskriminuese".

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për projektme të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016"*. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e projektimit duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- Licensat e kerkuara ne projektim:

- 1-c: Projektim Urbanist-Plane te Detajuara Vendore.

- 2 a,b-3,d: Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike - vepra arti ne infrastrukture - peizazh, sistemime sipërfaqe te gjelbera, lulishte e parqe.
- 3 a,c-2: Projektim objekte civile – industrial – turistike, prej murature dhe skelet beton arme deri ne 5 kate - troje dhe shpate me qendrueshmeri te ulet.
- 4 i: Projektim i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ.
- 5 c,d: Projektim vepra hidraulike, ujesjelles e kanalizime urbane-rurale, Vepra ujitje - kullimi impiante vaditëse - diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) –damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino.
- 6 a: Projektim rruge lokale, rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane dytesore.
- 7 a,b: Projektim ura dhe vepra arti deri me 10m, ura dhe vepra arti mbi 10m.
- 8 a,b: Projektim gjeodet per rlevime inxhinerike-rlevime inxhinerike kadastrale.
- 10 e: Projektim kabina elektrike ne rrjetin shperndares - linja te Tensioni te ulet – te Mesem.
- 11 a: Sinjalistike jondricuese ne rruge locale, urbane dytesore, rruge interurbane dytesore, sheshe dhe parkim.

a) Licence, Grupi 2 - Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, Nenkategoria: Veprimtarite e ekspertizes lidhur me vleresimin e ndikimit ne mjedis-Kodi: III.2A

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti operatori ekonomik duhet te paraqese licensen e shoqerise

-Argumentimi kriterit 2.3.2: Përcaktimi i kategorive dhe klasifikimit të licencave bazohet në kriteret e përcaktuara ligjore e teknike. Në kuptim të dispozitave në fuqi për licencimin profesional në projektim dhe në plotësim të kushteve që detyrat specifike në një shoqëri kryhen nga drejtues teknik të licencuar për ushtrimin e aktiviteteve respektive, kërkohet që dhe stafi profesional të ketë kualifikimet dhe i pajisur me licenca profesionale individuale sipas kualifikimeve dhe fushave të përgjegësisë që do të mbulojnë. Nisur nga fakti se hartimi i projekteve do të kërkojnë njohuri të plota në fusha të ndryshme të projektimit (në kuptim të dispozitave në fuqi për kontrollin e disiplinimin e punimeve në ndërtim dhe licencimin profesional në fushën përkatëse) gjykohet e domosdoshme që operatorët ekonomik të disponojnë licencë profesionale (si i vetmi dokument që i jep të drejtën për ushtrimin të kësaj veprimtarie) me të paktën kategoritë sipas obehjtit te kontrates. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur në përputhje me specififikimet teknike, termave të referencës, si dhe bazës ligjore për ndërimet, ligjit nr.8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar dhe VKM-së nr.759/2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudikimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” ndryshuar me VKM 943/2016. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me përshkrimin e përgjithshëm të detyrës së projektimit, ndërhyrjeve teknike të propozuara, fazave të përshkruara në termat e referencës, si dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet. Në vendosjen e këtij kriteri është mbajtur në konsideratë zbatimi i përcaktimive në LPP te ndryshuar, neni 46, pika 1/a, që parashikon se operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.

a) Licence, Grupi 2 - Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, Nenkategoria: Veprimtarite e ekspertizes lidhur me vleresimin e ndikimit ne mjedis-Kodi: III.2A.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti operatori ekonomik duhet te paraqese licensen e shoqerise.

-Argumentimi i kriterit 2.3.2/a: Garantimi i ekspertizës lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis është i rëndësishëm gjatë zbatimit të kontratës. Operatori ekonomik fitues gjatë fazës së zbatimit të kontratës duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë, për këtë qëllim subjekti duhet të jetë i licencuar për veprimtarinë e ekspertizës në vlerësimin e ndikimit në mjedis në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga ky i fundit për raportimin pranë autoritetit kontraktues. Operatorët ekonomikë, duhet të kenë kualifikimet dhe licencat përkatëse lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste zjarresh, ndotjesh të cilat mund të ndryshojnë cilësitë e mjedisit dhe të dëmtojnë cilësinë e jetës. Këto kualifikime kërkohen, nisur dhe nga rëndësia e objekteve dhe volumi i punimeve sipas standarteve e kushteve teknike, duke patur parasysh trajtimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta që do të dalin gjatë punimeve. Veprimtaria e shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile dhe të ndikimit në mjedis, është vendosur në përputhje me zbatimin e përcaktimeve në Ligjin nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, në VKM nr. 538 datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullimeve të tjera nënligjore të përbashkëta” të ndryshuar dhe në ligjin 10440/2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar,

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin projektues (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatoreve Ekonomike duhet te paraqesin nje liste te stafit kryesor te meposhtem, te cilet duhet te kene nje marredhenie kontraktore me operatorin apo partneret ne rastin e nje bashkimi operatoresh. I gjithë stafi kryesor i kerkuar duhet te jete i licensuar ne sherbimet e projektimit dhe duhet te zoteroje licensat profesionale sipas kategorive e renditura me poshte, perkatesisht per specialitetin qe mbulojne. Per çdo pozicion, operatorët janë të lire te propozojne me shume se nje kandidat, me qellim permbushjen e kriterëve te kerkuara. Pozicionet e stafit kryesor te kerkuar jane si më poshtë:

i- Stafi per sherbimin e projektimit

- a. Drejtues Projekti (Drejtues i grupit te projektimit) – Projektues rruges
- b. Urbanist.
- c. Arkitekt.
- d. Projektues Konstruktor.
- e. Projektues Instalator
- f. Projektues Ura dhe Vepra Arti.
- g. Projektues Hidroteknik.
- h. Projektues Elektrik.
- i. Projektues per sinjalistiken rrugore
- j. Projektues gjeodet
- k. Projektues gjeolog
- l. Specialist mjedisi

ii. Licensat qe duhet te zoteroje stafi kryesor

| | |
|------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|
| Drejtues Projekti (Drejtues i grupit te projektimit) Projektues rruges | 6 a; |
| Urbanist: Duhet te zoteroje license | 1-c |
| Akitekt: Duhet te zoteroje license | 2 a,b-3,d |
| Projektues Konstruktor: Duhet te zoteroje license | 3 a,c-2 |
| Projektues Instalator: Duhet te zoteroje license | 4 i; |
| Projektues Hidroteknik: Duhet te zoteroje license | 5 c,d; |
| Projektues Vepra Arti: Duhet te zoteroje license | 7 a,b; |
| Projektues Gjeodet: Duhet te zoteroje license | 8 a,b |
| Projektues Gjeolog: Duhet te zoteroje license | 9 d; |
| Projektues Elektrik: Duhet te zoteroje license | 10 e. |
| Projektues per Sinjalistikën Rrugore: Duhet te zoteroje license | 11 a; |
| Specialisi i Mjedisit: | Grupi 2, Kodi: III.2 A- Rregjistrim ne QKB |

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti duhet te paraqesin licensat perkatese.

ii. Drejtues Projekti, Arkitekt, Projektues Konstruktor, Projektues hidroteknik, duhet te jene pjese e stafit te shoqerise dhe te figurojne ne listepagesat e punonjesve te shoqerise per periudhen tre mujorit te fundit per periudhen Mars 2024 - Maj 2024

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Licencë për projektim, Diplomë dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

-Argumentimit për kriterin: Për shërbimin e projekteve teknike te detajuara te objekteve te konektivitetit, rikualifikimit te shesheve urbane, mobilimit urban, infrastrukturave urbanedhe fasada, peisazhe, gjykojmë se duhet të kryhet nga një staf profesional i kompeltuar me njohuri për fushat specifike dhe eksperiencën e mjaftueshme, për të garantuar kompletimin e standardeve në fushën përkatëse. Përcaktimi i stafit teknik për projektimin është bazuar tek elementet e produkteve të përcaktuara në termat e references. Kategoritë e licencave bazohen në parashikimet e VKM-së nr.759/2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudikimit të punimeve të zbatimit në ndërtim miratuar kriteret teknike dhe profesionale të kualifikimit”. Për të dokumentuar eksperiencën e stafit kryesor, si drejtuesi i Projektit, projektues rruges, arkitekt, projektues konstruktor, që zëne pjesën më të rëndësishme të punës, gjykojmë të kërkohen si dokument justifikues listepagesat e punonjesve te shoqerise per periudhen Mars 2024 - Maj 2024. Në vendosjen e këtij kriteri, është mbajtur në konsideratë kriteri i vlerësimit “oferta ekonomisht më të favorshme” e parashikuar në formularin e dokumenteve të tenderit.

Për të dokumentuar eksperiencën përvojën e operatorit ekonomik në tërësi dhe të stafit kryesor /profesional që zë pjesën më të rëndësishme të punës, gjykojmë të kërkohen dokumenta justifikuese standarde si, CV e firmosur nga vete personi dhe administrator dhe vertetime per realizimin te leshuar nga operatori.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 5 (pesë) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën tre mujore Mars 2024 - Maj 2024, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 9. *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën tre mujore Mars 2024 - Maj 2024
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën tre mujore Mars 2024 - Maj 2024.

-Argumentim për kriterin 2.3.4: Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje Mars 2024 - Maj 2024, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë listë pagesat e shoqëruara me formularët e deklarimit të pagesave shoqërore dhe shëndetësore me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpigjet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës (sidomos të grupeve të rrezikuara sikurse përcaktimet në shtojcën 8/1 të DST). Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

2.3.5 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë

ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të të sigurisë së informacionit janë standarte që çdo operator e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe sigurimin e informacionit. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë sigurinë e informacionit në format copy dhe elektronik në sistem..

Loti 2: “Hartimin e masterplaneve, dhe/ose përgatitje ToRs, dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit, dhe/ose përgatitje të dokumenteve për tenderim, për objekte civile, industriale, sportive, residenciale, publike dhe/ose kulturore, mbi tokë dhe nën tokë”, me fond limit të marrëveshjes kuadër 83,333,333 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 820,452.22 Euro.

2.3 Kapaciteti teknik:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës .3.;*
- b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës..9.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kritereve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik."

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet e fundit financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e Lotit (vlera e fondit limit)

Për operatorët e huaj, në rastet kur në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të vërtetuar bilancet/pasqyrat financiare apo xhiron vjetore, mund të paraqesin një deklaratë për konfirmin e tyre .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, atë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", I ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Argumentimi për kriterin në pikën 2.3.1: Ky kriter vërteton eksperiencën në fushën objekt prokurimi me qëllim realizimin sipas fazave të projektit dhe sipas afatit. Përvoja e operatorit është një element shumë i nevojshëm për autoritetin, për të vërtetuar qendrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Neni 46 i Ligjit 9643/2006, neni 28/3 të VKM-së 914/2014, janë bazat ligjore për vendosjen dhe miratimin e këtij kriteri. Në kuptim të nenit 46/1/b të

LPP-së, operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese”.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për projektme të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”*. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e projektimit duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- Licensat e kerkuara ne projektim:

- | | |
|------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1-c: | Projektim Urbanist-Plane te Detajuara Vendore. |
| 2 a, b-1, b-2, c,d: | Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike, objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara, qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore-Projektim interiere-Projektim peizazh, sistemime sipërfaqe te gjelbera, lulishte e parqe. |
| 3 a,b-1,b-2,c-1,c-2,e: | Projektim objekte civile – industrial – turistike, prej murature dhe skelet beton arme deri ne 5 kate, objekte civile – industrial – turistike mbi 5 kate objekte me skelet metalik, Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme – metalike, projektim troje dhe shpate me qendrushmeri te ulet - Objekte civile e turistike prej druri. |
| 4 a,b,c,f,j: | Projektim të instalimeve hidro-termosanitare, Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme-Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale-Projektim të sistemeve kundra zjarrit- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale. |
| 8 a,b: | Projektim gjeodet per rlevime inxhinerike-rilevime inxhinerike kadastrale. |
- a) Licence, Grupi 2 - Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, Nenkategoria: Veprimtarite e ekspertizes lidhur me vleresimin e ndikimit ne mjedis-Kodi: III.2A
- b) Shërbime per auditimin dhe hartimin e raportit te eficences se energjise

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti operatori ekonomik duhet te paraqese licensen e shoqerise.

-Argumentimi kriterit 2.3.2: Përcaktimi i kategorive dhe klasifikimit të licencave bazohet në kriteret e përcaktuara ligjore e teknike. Në kuptim të dispozitave në fuqi për licencimin profesional në projektim dhe në plotësim të kushteve që detyrat specifike në një shoqëri kryhen nga drejtues teknik të licencuar për ushtrimin e aktiviteteve respektive, kërkohet që dhe stafi profesional të ketë kualifikimet dhe i pajisur me

licenca profesionale individuale sipas kualifikimeve dhe fushave të përgjegjësive që do të mbulojnë. Nisur nga fakti se hartimi i projekteve do të kërkojnë njohuri të plota në fusha të ndryshme të projektimit (në kuptim të dispozitave në fuqi për kontrollin e disiplinimin e punimeve në ndërtim dhe licencimin profesional në fushën përkatëse) gjykohet e domosdoshme që operatorët ekonomik të disponojnë licencë profesionale (si i vemi dokument që i jep të drejtën për ushtrimin të kësaj veprimtarie) me të paktën kategoritë të cilat i japin të drejtën e ushtrimin të veprimtarisë në fushën e studimeve me përgatitjen e projekt ideve teknik që kanë synim zhvillimin e zonave malore, bregdetare, turistike, ekonomike, sigurimin e infrastrukturës mbështetëse në zonat me potencial për zhvillim turizimi etj. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur në përputhje me specifikimet teknike, termave të referencës, si dhe bazës ligjore për ndërtim, ligjit nr.8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar dhe VKM-së nr.759/2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrorjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudikimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” ndryshuar me VKM 943/2016. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me përshkrimin e përgjithshëm të detyrës së projektimit, ndërhyrjeve teknike të propozuara, fazave të përshkruara në termat e referencës, si dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet. Në vendosjen e këtij kriteri është mbajtur në konsideratë zbatimi i përcaktimive në LPP te ndryshuar, neni 46, pika 1/a, që parashikon se operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.

a) Licence, Grupi 2 - Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, Nenkategoria: Veprimtarite e ekspertizes lidhur me vlerësimin e ndikimit ne mjedis-Kodi: III.2A.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti operatori ekonomik duhet te paraqese licensen e shoqerise.

-Argumentimi i kriterit 2.3.2/a: Garantimi i ekspertizës lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis është i rëndësishëm gjatë zbatimit të kontratës. Operatori ekonomik fitues gjatë fazës së zbatimit të kontratës duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë, për këtë qëllim subjekti duhet të jetë i licencuar për veprimtarinë e ekspertizës në vlerësimin e ndikimit në mjedis në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga ky i fundit për raportimin pranë autoritetit kontraktues.

Operatorët ekonomikë, duhet të kenë kualifikimet dhe licencat përkatëse lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste zjarresh, ndotjesh të cilat mund të ndryshojnë cilësitë e mjedisit dhe të dëmtojnë cilësinë e jetës. Këto kualifikime kërkohen, nisur dhe nga rëndësia e objekteve dhe volumi i punimeve sipas standarteve e kushteve teknike, duke patur parasysh trajtimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta që do të dalin gjatë punimeve. Veprimtaria e shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile dhe të ndikimit në mjedis, është vendosur në përputhje me zbatimin e përcaktimeve në Ligjin nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, në VKM nr. 538 datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullimeve të tjera nënligjore të përbashkëta” të ndryshuar dhe në ligjin 10440/2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin projektues (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë, Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatoreve Ekonomike duhet të paraqesin një liste të stafit kryesor të meposhtem, të cilët duhet të kenë një marrëdhënie kontraktore me operatorin apo partnerët në rastin e një bashkimi operatorësh. I gjithë stafi kryesor i kërkuar duhet të jetë i licensuar në shërbimet e projektimit dhe duhet të zotërojë licencat profesionale sipas kategorive të renditura më poshtë, të përfshijë specialitetin që mbulojnë. Për çdo pozicion, operatorët janë të lirë të propozojnë më shumë se një kandidat, me qëllim përmbushjen e kriterëve të kërkuara. Pozicionet e stafit kryesor të kërkuar janë:

i- Stafit për shërbimin e projektimit

- a. Drejtues Projekti (Drejtues i grupit të projektimit) – Arkitekt
- b. Urbanist
- c. Projektues Konstruktore
- d. Projektues Instalator
- e. Projektues gjeodet
- f. Projektues gjeolog
- g. Projektues gjeosizmik
- h. Specialit mjedisi

ii. Licencat që duhet të zotërojë stafi kryesor

| | |
|---------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|
| Drejtues Projekti (Drejtues i grupit të projektimit) Arkitekt | 2 a, b-1, b-2, c,d; |
| Urbanist | 1-c; |
| Projektues Konstruktore | 3 a,b-1,b-2,c-1,c-2,e; |
| Projektues Instalator | 4 a,b,c,f,j |
| Projektues Gjeodet | 8 a,b; |
| Projektues Gjeolog | 9 a,b; |
| Projektues Gjeosizmik | 12 a,b; |
| Specialisi i Mjedisit: | Grupi 2, Kodi: III.2 A- Rregjistrim në QKB |

Për të vertetuar plotësimin e këtij kushti duhet të paraqesin licencat përkatëse.

ii. Drejtues Projekti Arkitekt, Projektues Konstruktore, Projektues instalator, duhet të jenë pjesë e stafit të shoqërisë dhe të figurojnë në listëpagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën tre Mars 2024 - Maj 2024
 *** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Licencë për projektim, Diplomë, dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

-Argumentimit për kriterin 2.3.3: Për shërbimin e projekteve teknike të detajuara të objekteve të konektivitetit, rikualifikimit të shesheve urbane, mobilimit urban, infrastrukturave urbanedhe fasada, peisazhe, gjykojmë se duhet të kryhet nga një staf profesional i kompeltuar me njohuri për fushat specifike dhe eksperiencën e mjaftueshme, për të garantuar kompletimin e standardeve në fushën përkatëse. Përcaktimi i stafit teknik për projektimin është bazuar tek elementet e produkteve të përcaktuara në termat e references. Kategoritë e licencave bazohen në parashikimet e VKM-së nr.759/2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudikimit të punimeve të zbatimit në ndërtimratuan kriteret teknike dhe profesionale të kualifikimit”.

Për të dokumentuar eksperiencën e stafit kryesor, si drejtuesi i Projektit, projektues rruges, arkitekt, projektues konstruktor, projektues hidroteknik, specialist mjedisi që zëne pjesën më të rëndësishme të punës, gjykojmë të kërkohen si dokument justifikues listepagesat e punonjesve të shoqërisë për periudhën Mars 2024 - Maj 2024. Në vendosjen e këtij kriteri, është mbajtur në konsideratë kriteri i vlerësimit “oferta ekonomisht më të favorshme” e parashikuar në formularin e dokumenteve të tenderit. Për të dokumentuar eksperiencën përvojën e operatorit ekonomik në tërësi dhe të stafit kryesor /profesional që zë pjesën më të rëndësishme të punës, gjykojmë të kërkohen dokumenta justifikuese standarde si, CV e firmosur nga vete personi dhe administrator dhe vertetime për realizimin të leshuar nga operatori.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 5 (pesë) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën tre mujore (Mars 2024 - Maj 2024), në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën tre mujore Mars 2024 - Maj 2024
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën tre mujore Mars 2024 - Maj 2024

-Argumentim për kriterin 2.3.4: Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje Mars 2024 - Maj 2024, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë listë pagesat e shoqëruara me formularët e deklarimit të pagesave shoqërore dhe shëndetësore me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpigjet të

kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës (sidomos të grupeve të rrezikuara sikurse përcaktimet në shtojcën 8/1 të DST). Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

2.3.5 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor
- ISO 45001 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi 2.3.5: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të të sigurisë së informacionit janë standarde që çdo operator e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cillesi dhe sigurimin e informacionit. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë sigurinë e informacionit ne format copy dhe elektronik ne sistem..

Loti 3: “Hartimin e masterplaneve, dhe/ose përgatitje ToRs, dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose projekteve të zbatimit, dhe/ose përgatitje të dokumenteve për tenderim, për objekte të trashëgimisë kulturore, restaurime të monumenteve të kulturës apo objekte të tjera të trashëgimisë kulturore, realizimin e muzeve (bashkohore apo trashigimi kulturore), galeri arti, arredim/interiere dhe/ose muzealizim”, me fond limit të marrëveshjes kuadër 41,666,667 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 410,226.11 Euro.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës .3.;*

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës.9..

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kritereve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet e fundit financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jo më të vogël se vlera e parashikuar e Lotit (fondit të limit të lotit.

Për operatorët e huaj, në rastet kur në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të vërtetuar bilancet/pasqyrat financiare apo xhiron vjetore, mund të paraqesin një deklaratë për konfirmimin e tyre .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, ate 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", I ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shumën e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b)për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Argumentimi për kriterin në pikën 2.3.1: Ky kriter vërteton eksperiencën në fushën objekt prokurimi me qëllim realizimin sipas fazave të projektit dhe sipas afatit. Përvoja e operatorit është një element shumë i nevojshëm për autoritetin, për të vërtetuar qendrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Neni 46 i Ligjit 9643/2006, neni 28/3 të VKM-së 914/2014, janë bazat ligjore për vendosjen dhe miratimin e këtij kriteri. Në kuptim të nenit 46/1/b të LPP-së, operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese”.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për projektme të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”*. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e projektimit duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- Licensat e kerkuara ne projektim:

- 1-c: Projektim Urbanist-Plane te Detajuara Vendore.
- 2 a,b-3,c,d: Projektim arkitekturor per objekte turistike; vepra arti ne infrastrukture; interior; peizazh, sistemime siperfaqe te gjelbera, lulishte e parqe.
- 3 a,c-2: Projektim objekte civile- industrial- turistike me murature e skelet betonarme deri ne 5 kate; troje dhe shpate me qendrueshmeri te ulet.
- 4 c,f,g,j Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale; Projektim të sistemeve kundra zjarrit; Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.
- 5 b: Projektim vepra hidraulike, Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi
- 8 a,b: Projektim gjeodet per rilevime inxhinerike - rilevime inxhinerike kadastrale,
- AP/1. Projektim në konservimin e restaurimin e rrënojave arkeologjike”;
- AP/2. Projektim në restaurimin e monumenteve të arkitekturës antiko – mesjetare,
- AP/3. Projektim në restaurimin e ndërtimeve civile, monumente të kategorisë së pare dhe të dytë”;

a) Licence, Grupi 2 - Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, Nenkategoria: Veprimtarite e ekspertizes lidhur me vleresimin e ndikimit ne mjedis-Kodi: III.2A

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti operatori ekonomik duhet te paraqese licensen e shoqerise.

-Argumentimi kriterit 2.3.2: Përcaktimi i kategorive dhe klasifikimit të licencave bazohet në kriteret e përcaktuara ligjore e teknike. Në kuptim të dispozitave në fuqi për licencimin profesional në projektim dhe në plotësim të kushteve që detyrat specifike në një shoqëri kryhen nga drejtues teknik të licencuar për ushtrimin e aktiviteteve respektive, kërkohet që dhe stafi profesional të ketë kualifikimet dhe i pajisur me licenca profesionale individuale sipas kualifikimeve dhe fushave të përgjegësisë që do të mbulojnë. Nisur nga fakti se hartimi i projekteve do të kërkojnë njohuri të plota në fusha të ndryshme të projektimit (në kuptim të dispozitave në fuqi për kontrollin e disiplinimin e punimeve në ndërtim dhe licencimin profesional në fushën përkatëse) gjykohet e domosdoshme që operatorët ekonomik të disponojnë licencë profesionale (si i vemi dokument që i jep të drejtën për ushtrimin të kësaj veprimtarie) me të paktën kategoritë të cilat i japin të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë në fushën e studimeve me përgatitjen e projekt ideve teknik që kanë synim zhvillimin e zonave malore, bregdetare, turistike, ekonomike, sigurimin e infrastrukturës mbështetëse në zonat me potencial për zhvillim turizimi etj. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur në përputhje me specifikimet teknike, termave të referencës, si dhe bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr.8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimiti” të ndryshuar dhe VKM-së nr.759/2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudikimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” ndryshuar me VKM 943/2016. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me përshkrimin e përgjithshëm të detyrës së projektimit, ndërhyrjeve teknike të propozuara, fazave të përshkruara në termat e referencës, si dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet. Në vendosjen e këtij kriteri është mbajtur në konsideratë zbatimi i përcaktimive në LPP te ndryshuar, neni 46, pika 1/a, që parashikon se operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.

a) Licence, Grupi 2 - Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, Nenkategoria: Veprimtarite e ekspertizes lidhur me vleresimin e ndikimit ne mjedis-Kodi: III.2A.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti operatori ekonomik duhet te paraqese licensen e shoqerise.

-Argumentimi i kriterit 2.3.2/a: Garantimi i ekspertizës lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis është i rëndësishëm gjatë zbatimit të kontratës. Operatori ekonomik fitues gjatë fazës së zbatimit të kontratës duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë, për këtë qëllim subjekti duhet të jetë i licencuar për veprimtarinë e ekspertizës në vlerësimin e ndikimit në mjedis në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga ky i fundit për raportimin pranë autoritetit kontraktues.

Operatorët ekonomikë, duhet të kenë kualifikimet dhe licencat përkatëse lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste zjarresh, ndotjesh të cilat mund të ndryshojnë cilësitë e mjedisit dhe të dëmtojnë cilësinë e jetës. Këto kualifikime kërkohen, nisur dhe nga rëndësia e objekteve

dhe volumi i punimeve sipas standarteve e kushteve teknike, duke patur parasysh trajtimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta që do të dalin gjatë punimeve. Veprimtaria e shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile dhe të ndikimit në mjedis, është vendosur në përputhje me zbatimin e përcaktimeve në Ligjin nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, në VKM nr. 538 datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullimeve të tjera nënligjore të përbashkëta” të ndryshuar dhe në ligjin 10440/2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar,

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin projektues (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë, Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatoreve Ekonomike duhet të paraqesin një listë të stafit kryesor të meposhtem, të cilët duhet të kenë një marrëdhënie kontraktore me operatorin apo partneret në rastin e një bashkimi operatorësh. I gjithë stafi kryesor i kërkuar duhet të jetë i licensuar në shërbimet e projektimit dhe duhet të zotërojë licensat profesionale sipas kategorive të renditura më poshtë, përkatësisht për specialitetin që mbulojnë. Për çdo pozicion, operatorët janë të lirë të propozojnë më shumë se një kandidat, me qëllim përmbushjen e kriterëve të kërkuara. Pozicionet e stafit kryesor të kërkuar janë:

i- Stafi për shërbimin e projektimit

- a. Drejtues Projekti (Drejtues i grupit të projektimit) – Projektues Arkitekt
- b. Urbanist
- c. Projektues Konstruktore
- d. Projektues Instalator
- e. Projektues Hidroteknik
- f. Projektues gjeodet
- g. Projektues gjeolog
- h. Specialit mjedisi
- i. Projektues në konservim dhe restaurim
- j. Arkeolog

ii. Licensat që duhet të zotërojë stafi kryesor

| | |
|---------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|
| Drejtues Projekti (Drejtues i grupit të projektimit) Arkitekt | a,b-3,c,d |
| Urbanist | 1-c |
| Projektues Konstruktore | 3 a,c-2 |
| Projektues Instalator | 4 c,f,g,j |
| Projektues Hidroteknik | 5 b |
| Projektues Gjeodet | 8 a,b |
| Projektues Gjeolog | 9 a,c |
| Specialisi i Mjedisit | Grupi 2, Kodi: III.2 A- Rregjistrim në QKB |
| Projektues në konservim dhe restaurim | Ap/1 |
| Projektues në konservim dhe restaurim | Ap/2 |
| Projektues në konservim dhe restaurim | Ap/3 |

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti duhet te paraqesin licensat perkatese.

ii. Drejtues Projekti Arkitekt, Projektues Konstruktor, Projektues instalator, Specialist mjedisi duhet te jene pjese e stafit te shoqerise dhe te figurojne ne listepagesat e punonjesve te shoqerise per periudhen tre mujorit te fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Licencë për projektim, Diplomë dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

-Argumentimit për kriterin 2.3.3: Për shërbimin e projekteve teknike te detajuara te objekteve te konektivitetit, rikualifikimit te shesheve urbane, mobilimit urban, infrastrukturave urbanedhe fasada, peisazhe, gjykojmë se duhet të kryhet nga një staf profesional i kompeltuar me njohuri për fushat specifike dhe eksperiencën e mjaftueshme, për të garantuar kompletimin e standardeve në fushën përkatëse. Përcaktimi i stafit teknik për projektimin është bazuar tek elementet e produkteve të përcaktuara në termat e references. Kategoritë e licencave bazohen në parashikimet e VKM-së nr.759/2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudikimit të punimeve të zbatimit në ndërtimratuan kriteret teknike dhe profesionale të kualifikimit”.

Për të dokumentuar eksperiencën e stafit kryesor, si drejtuesi i Projektit, projektues rruges, arkitekt, projektues konstruktor, projektues hidroteknik, specialist mjedisi që zëne pjesën më të rëndësishme të punës, gjykojmë të kërkohen si dokument justifikues listepagesat e punonjesve te shoqerise per periudhen Mars 2024 - Maj 2024. Në vendosjen e këtij kriteri, është mbajtur në konsideratë kriteri i vlerësimit “oferta ekonomisht më të favorshme” e parashikuar në formularin e dokumenteve të tenderit.

Për të dokumentuar eksperiencën përvojën e operatorit ekonomik në tërësi dhe të stafit kryesor /profesional që zë pjesën më të rëndësishme të punës, gjykojmë të kërkohen dokumenta justifikuese standarde si, CV e firmosur nga vete personi dhe administrator dhe vertetime per realizimin te leshuar nga operatori.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 5 (pesë) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën tre mujore (Mars 2024 - Maj 2024) , në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën tre mujore Mars 2024 - Maj 2024
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën tre mujore. Mars 2024 - Maj 2024
- -Argumentim për kriterin 2.3.: Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje Mars 2024 - Maj 2024, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë listë pagesat e shoqëruara me formularët e deklarimit të pagesave shoqërore dhe shëndetësore me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës (sidomos të grupeve të rrezikuara sikurse përcaktimet në shtojcën 8/1 të DST). Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

2.3.5 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor
- ISO 45001 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të të sigurisë së informacionit janë standarde që çdo operator e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe sigurimin e informacionit. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund

të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë sigurinë e informacionit në format copy dhe elektronik në sistem..

Loti 4: “Hartimin e masterplaneve, dhe/ose projekteve teknologjike, dhe/ose projekteve të detajuara, dhe/ose përgatitje të termave të referencës, dhe/ose përgatitje të dokumenteve për tenderim, për objekte industriale, teknologji, informacion, objekte ekologjike miqësore me mjedisin, bio-teknologjike, me efikasitet energjie, industriale, mekanike, impiante, sinjalistike, kontrolle aksesit, sisteme të automatizuara, impianti trajtimi ujërash, përpunim bimesh medicinale, përpunim qumështi, blegtori, bujqësi etj”, me fond limit të marrëveshjes kuadër 41,666,666 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 410,226.11 Euro.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës..9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet e fundit financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jo më të vogël se vlera e parashikuar e Lotit (fondit të limit të lotit).

Për operatorët e huaj, në rastet kur në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të vërtetuar bilancet/pasqyrat financiare apo xhiron vjetore, mund të paraqesin një deklaratë për konfirmimin e tyre .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, I ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shumën e të ardhurave

nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Argumentimi për kriterin në pikën 2.3.1: Ky kriter vërteton eksperiencën në fushën objekt prokurimi me qëllim realizimin sipas fazave të projektit dhe sipas afatit. Përvoja e operatorit është një element shumë i nevojshëm për autoritetin, për të vërtetuar qendrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Neni 46 i Ligjit 9643/2006, neni 28/3 të VKM-së 914/2014, janë bazat ligjore për vendosjen dhe miratimin e këtij kriteri. Në kuptim të nenit 46/1/b të LPP-së, operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese".

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për projektme të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016*". Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e projektimit duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- Licensat e kerkuara ne projektim:

2 a: Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale;

3 a,b-2,d: Projektim objekte civile – industrial – turistike, prej murature dhe skelet beton arme deri ne 5 kate; objekte me skelet metalik; Vleresim kapaciteti mbajtes dhe perforcimi i strukturave mbajtese prej beton-arme, murature dhe metalike.

- 4 a,b,c,f,g,j: Projektim të instalimeve hidro-termosanitare; Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme; Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale; Projektim të sistemeve kundra zjarrit; Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa, Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.
- 8 a: Projektim gjeodet per rlevime inxhinerike.

a) Licence, Grupi 2 - Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, Nenkategoria: Veprimtarite e ekspertizes lidhur me vleresimin e ndikimit ne mjedis-Kodi: III.2A

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti operatori ekonomik duhet te paraqese licensen e shoqerise.

-Argumentimi kriterit 2.3.2: Përcaktimi i kategorive dhe klasifikimit të licencave bazohet në kriteret e përcaktuara ligjore e teknike. Në kuptim të dispozitave në fuqi për licencimin profesional në projektim dhe në plotësim të kushteve që detyrat specifike në një shoqëri, kryhen nga drejtues teknik të licencuar për ushtrimin e aktiviteteve respektive, kërkohet që dhe stafi profesional të ketë kualifikimet dhe i pajisur me licenca profesionale individuale sipas kualifikimeve dhe fushave të përgjegësisë që do të mbulojnë. Nisur nga fakti se hartimi i projekteve do të kërkojnë njohuri të plota në fusha të ndryshme të projektimit gjykohet e domosdoshme që operatorët ekonomik të disponojnë licencë profesionale, si i vemi dokument që i jep të drejtën për ushtrimin të kësaj veprimtarie. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me përshkrimin e përgjithshëm të fazave të përshkruara në termat e referencës, si dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet. Këto kategori licenca të vendosura në përputhje me termat e referencës, janë sipas përshkrimeve të parashikuara VKM-së nr.759/2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrorjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudikimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” ndryshuar me VKM 943/2016 dhe ligjit nr.8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimiti” të ndryshuar dhe. Në vendosjen e këtij kriteri është mbajtur në konsideratë zbatimi i përcaktimive në LPP te ndryshuar, neni 46, pika 1/a, që parashikon se operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.

a) Licence, Grupi 2 - Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, Nenkategoria: Veprimtarite e ekspertizes lidhur me vleresimin e ndikimit ne mjedis-Kodi: III.2A.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti operatori ekonomik duhet te paraqese licensen e shoqerise.

-Argumentimi i kriterit 2.3.2/a: Garantimi i ekspertizës lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis është i rëndësishëm gjatë zbatimit të kontratës. Operatori ekonomik fitues gjatë fazës së zbatimit të kontratës duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë, për këtë qëllim subjekti duhet të jetë i licencuar për veprimtarinë e ekspertizës në vlerësimin e ndikimit në mjedis në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga ky i fundit për raportimin pranë autoritetit kontraktues. Operatorët ekonomikë, duhet të kenë kualifikimet dhe licencat përkatëse lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste zjarresh, ndotjesh të cilat mund të

ndryshojnë cilësitë e mjedisit dhe të dëmtojnë cilësinë e jetës. Këto kualifikime kërkohen, nisur dhe nga rëndësia e objekteve dhe volumi i punimeve sipas standarteve e kushteve teknike, duke patur parasysh trajtimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta që do të dalin gjatë punimeve. Veprimtaria e shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile dhe të ndikimit në mjedis, është vendosur në përputhje me zbatimin e përcaktimeve në Ligjin nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, në VKM nr. 538 datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullimeve të tjera nënligjore të përbashkëta” të ndryshuar dhe në ligjin 10440/2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar,

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin projektues (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë, Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatoreve Ekonomike duhet të paraqesin një listë të stafit kryesor të meposhtem, të cilët duhet të kenë një marrëdhënie kontraktore me operatorin apo partneret në rastin e një bashkimi operatorësh. I gjithë stafi kryesor i kërkuar duhet të jetë i licensuar në shërbimet e projektimit dhe duhet të zotërojë licensat profesionale sipas kategorive të renditura më poshtë, përkatësisht për specialitetin që mbulojnë. Për çdo pozicion, operatorët janë të lirë të propozojnë më shumë se një kandidat, me qëllim përmbushjen e kriterëve të kërkuara. Pozicionet e stafit kryesor të kërkuar janë:

i- Stafit për shërbimin e projektimit

- a. Drejtues Projekti (Drejtues i grupit të projektimit) – Projektues instalator
- b. Arkitekt
- c. Projektues Konstruktor
- d. Projektues gjeodet
- e. Specialit mjedisi

ii. Licensat që duhet të zotërojë stafi kryesor

| | |
|-----------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|
| Drejtues Projekti (Drejtues i grupit të projektimit) Instalator | 4 a,b,c,f,g,j |
| Arkitekt | 2 a |
| Projektues Konstruktor | 3 a,b-2,d |
| Projektues Gjeodet | 8 a |
| Specialisi i Mjedisit: Duhet të zotërojë License | Grupi 2, Kodi: III.2 A- Rregjistrim në QKB |

Për të vertetuar plotësimin e këtij kushti duhet të paraqesin licensat përkatëse.

ii. Drejtues Projekti Instalator, Arkitekt, Projektues Konstruktor, duhet të jenë pjesë e stafit të shoqërisë dhe të figurojnë në listëpagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën tre mujore. Mars 2024 - Maj 2024

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Licencë për projektim, Diplomë dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

-Argumentimit për kriterin 2.3.3: Për shërbimin e projekteve teknike të detajuara të objekteve të konektivitetit, rikualifikimit të shesheve urbane, mobilimit urban, infrastrukturave urbanedhe fasada, peisazhe, gjykojmë se duhet të kryhet nga një staf profesional i kompletuar me njohuri për fushat specifike dhe eksperiencën e mjaftueshme, për të garantuar kompletimin e standardeve në fushën përkatëse. Përcaktimi i stafit teknik për projektimin është bazuar tek elementet e produkteve të përcaktuara në termat e references. Kategoritë e licencave bazohen në parashikimet e VKM-së nr.759/2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudikimit të punimeve të zbatimit në ndërtimratuan kriteret teknike dhe profesionale të kualifikimit”.

Për të dokumentuar eksperiencën e stafit kryesor, si drejtuesi i Projektit, projektues rruges, arkitekt, projektues konstruktor, projektues hidroteknik, specialist mjedisi që zënë pjesën më të rëndësishme të punës, gjykojmë të kërkohen si dokument justifikues listepagesat e punonjesve të shoqërisë për periudhën Mars 2024 - Maj 2024. Në vendosjen e këtij kriteri, është mbajtur në konsideratë kriteri i vlerësimit “oferta ekonomisht më të favorshme” e parashikuar në formularin e dokumenteve të tenderit.

Për të dokumentuar eksperiencën përvojën e operatorit ekonomik në tërësi dhe të stafit kryesor /profesional që zë pjesën më të rëndësishme të punës, gjykojmë të kërkohen dokumenta justifikuese standarde si, CV e firmosur nga vete personi dhe administrator dhe vertetime për realizimin të leshuar nga operatori.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 4 (katër) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën tre mujore (Mars 2024 - Maj 2024) , në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 9. “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese*”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën tre mujore Mars 2024 - Maj 2024
- Listepagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën tre mujore Mars 2024 - Maj 2024

-Argumentim për kriterin 2.3.4: Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje Mars 2024 - Maj 2024, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të

kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë listë pagesat e shoqëruara me formularët e deklarimit të pagesave shoqërore dhe shëndetësore me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpigjet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës (sidomos të grupeve të rrezikuara sikurse përcaktimet në shtojcën 8/1 të DST). Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

2.3.5 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor
- ISO 45001 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të të sigurisë së informacionit janë standarde që çdo operator e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cillesi dhe sigurimin e informacionit. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë sigurinë e informacionit në format copy dhe elektronik në sistem..

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto

Sipas rëndësisë:

çmimi pikët

_____ pikët

_____ pikët

_____ pikët

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit

OSE

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Në rastin e marrëveshjes kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi (Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasi të janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).

Çmimi (në përputhje me kërkesat e VKM nr.354 datë 11.5.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim të territorit).

B.1 Faza 1- (Kualifikimi/ Marrëveshja Kuadër)

Per kete fazë, kriteret e përzgjedhjes se operatoreve ekonomik pale ne marreveshjen kuader, do te jete, çmimi kërkesat e përgjithshme dhe të vecantat të kualifikimit

(Çmimi në përputhje me kërkesat e VKM nr.354 datë 11.5.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim të territorit) (jo me te vogel se tarifa minimale sipas VKM 354/2016), kërkesat e përgjithshme dhe te vecanta per kualifikim.

B.2 Faza 2 – Minikonkursi

Per shkak te natyres intelektuale te kesaj/ketyre kontratave sherbimi, Autoriteti Kontraktor ne fazen e minikonkursit do te perfshije ne ftesen per oferte si kriteret e përzgjedhjes:

Sipas rëndësisë:

- | | | |
|------------------------------------------------|-------|--------|
| 1. Çmimi | pikët | 50 |
| 2. Propozimi teknik | pikët | 50 |
| (i) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar | | 0- 15 |
| (ii) Metodologjia e Propozuar | | 0 - 10 |

(Përçqasja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)

(iii) Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit 0 - 10

(iv) Zgjidhja/Koncept fillestar i projektit (skice/vizatim) (*nese kerkohet*) 0 - 15

Kriteri Çmimi [50] pike

Kriteri i cmimit me 50 pikë është i bazuar në rregullat e prokurimit publik, ku parashikohet minimalisht 50 pike.

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe - Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu - Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç - Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Kriteri Propozimi teknik [50] pike

Kriteri, Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

i) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [0- 15]

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm [5-20%]

b- Eksperiencia në fushën përkatëse [30-80 %]

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.

- Eksperiencia në fushën përkatëse përfshin: eksperiencia në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme

- *Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4, nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.*

ii) Metodologjia e Propozuar [0 – 10]

(Përçqasja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)

Nenkriteret

ii/a. Përçqasja teknike dhe metodologjia [10-30%]

ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit [30-40%]

ii/a. Përfaqja teknike dhe metodologjia: Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përfaqjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme, duke përfituar rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përfaqjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me qërfaqjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlikohen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përfaqjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

ii/c. Organizimi dhe Stafit: Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomik-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

(iii) Përvoja për Pune të Ngjashme të Konsulentit [0 – 10]

Nënkriteret

iii/a Përvoja për punë të ngjashme 40-80%

Operatorët ekonomikë, të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

iii/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë 10-20%

Operatorët ekonomikë të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

(iv) Zgjidhja/Koncept fillestar i projektit (skice/vizatim) (nese kerkohe) 0 - 15

Nëse transferimi i njohurive nuk aplikohet (nuk kërkohet), atëherë pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t'i shtohen kriterit "Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar".

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.5)$

Pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.5)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

Oferta më e mirë = X + Y

Formula me të cilën do të llogariten pikët e ofertuesve në këtë rast është:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për çdo kriter përlllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = V_{min} k1 \times P_{max} k1 / O_{k1}$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{min} k1 Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

P_{max}k1 Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Oferta më e mirë $Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + Pk4$

Piket dhe pesha e vendosur për secilin nenkriter gjatë zhvillimit të fazës së minikonkursit, do të variojnë brenda kufijve të përcaktuar më sipër.

Nenkriteri (iv) do të përcaktohet në fazat e tjera të procedurës, në varesi kjo të nevojës konkrete që Autoriteti Kontraktor do të ketë, bazuar në elementet e shërbimit të listuar në seksionin xxxx të Termave të Referencës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Termet e referencës janë hartuar sipas standardeve dhe në përputhje me perçkatimet ligjore në fuqi dhe janë pjesë e pandare e DST